

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Korrik 2025

Tiranë, më 22 Gusht 2025: Gjatë muajit Korrik 2025, rezultojnë të kenë hyrë, në territorin e Republikës së Shqipërisë, 2.663.010 shtetas shqiptarë dhe të huaj. Ky tregues ka pësuar një rritje me 1,5 %, krahasuar me Korrik 2024.


2.576.342 shtetas shqiptarë dhe të huaj rezultojnë të kenë dalë nga territori i Republikës së Shqipërisë, duke shënuar një rritje me 9,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Hyrjet e shtetasve

Në Korrik 2025, numri i shtetasve shqiptarë që kanë hyrë në territorin shqiptar është 837.520, duke pësuar një rritje me 3,9 %, krahasuar me Korrik 2024.

Numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 1.825.490. Ky numër është rritur me 0,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 (fig.1).

Fig.1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri, Korrik 2024 - Korrik 2025



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Për publikim 22/08/2025

Daljet e shtetasve

Në muajin Korrik 2025, 782.849 shtetas shqiptarë numërohen të kenë dalë nga territori i Shqipërisë, duke shënuar rritje me 11,1 %, krahasuar me Korrik 2024.

Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Korrik 2025, janë 1.793.493. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ky tregues është rritur me 9,0 % (tab.1).

Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periudha	Korrik 2024	Korrik 2025	Ndryshimi vjetor %	Janar - Korrik 2024	Janar - Korrik 2025	Ndryshimi vjetor %
Hyrje Gjithsej	2.624.207	2.663.010	1,5	10.712.937	11.260.922	5,1
Shqiptarë	805.829	837.520	3,9	4.350.891	4.673.781	7,4
Të Huaj	1.818.378	1.825.490	0,4	6.362.046	6.587.141	3,5
Dalje Gjithsej	2.350.448	2.576.342	9,6	10.553.655	11.245.218	6,6
Shqiptarë	704.699	782.849	11,1	4.378.426	4.771.121	9,0
Të Huaj	1.645.749	1.793.493	9,0	6.175.229	6.474.097	4,8

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Në Korrik 2025, 95 % e hyrjeve të shtetasve të huaj në Shqipëri janë nga rajoni i Evropës.

Evropa Jugore zë 68 % të hyrjeve të shtetasve të huaj nga kontinenti Evropian, ndjekur nga Evropa Perëndimore me 12 % dhe Evropa Qëndrore / Lindore me 10 % (tab.2).

Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas rajonit

Periudha	Korrik 2024	Korrik 2025	Janar -Korrik 2024	Janar -Korrik 2025
Gjithsej	1.818.378	1.825.490	6.362.046	6.587.141
I . Afrika	3.177	5.597	15.489	24.681
II. Amerika	56.840	63.411	170.932	193.364
III. Azia Lindore dhe Paqësori	12.618	15.963	47.631	60.349
IV.Lindja e Mesme	8.086	7.425	18.603	20.232
V. Azia e Jugut	2.334	3.401	15.324	25.976
VI. Evropa	1.722.403	1.728.437	6.049.198	6.255.487
- Evropa Qëndrore / Lindore	168.858	174.318	465.747	466.477
- Evropa Veriore	90.571	105.314	278.917	311.859
- Evropa Jugore	1.219.109	1.173.789	4.578.212	4.602.154
- Evropa Perëndimore	166.440	210.196	513.077	652.943
- Evropa Lindore / Mesdheut	77.425	64.820	213.245	222.054
VII. Rajone të paspecifikuara	12.920	1.256	44.869	7.052

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Qëllimi i hyrjes në territorin shqiptar i shtetasve të huaj, në 99 % të rasteve është për qëllime personale. Në Korrik 2025, ky tregues ka shënuar një rritje me 0,2 %, krahasuar me Korrik 2024. Hyrjet e shtetasve të huaj për qëllime Biznesi dhe profesionale janë rritur me 15,6 % (tab.3).

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periudha	Korrik 2024	Korrik 2025	Ndryshimi vjetor %	Janar - Korrik 2024	Janar - Korrik 2025	Ndryshimi në %
Hyrje shtetas të huaj	1.818.378	1.825.490	0,4	6.362.046	6.587.141	3,5
I. Personale	1.798.470	1.802.475	0,2	6.241.892	6.440.136	3,2
1. Pushime, vizitë tek të afërm. etj.	1.734.238	1.676.601	-3,3	6.031.266	6.099.880	1,1
2. Trajtime shëndetësorë	53	64	20,8	483	245	-49,3
3. Qëllime fetare	80	130	62,5	230	297	29,1
4. Udhëtarë transit	64.099	125.680	96,1	209.913	339.714	61,8
II. Biznes dhe profesionale	19.908	23.015	15,6	120.154	147.005	22,3

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Metodologjia

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

Përkufizime

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet: Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

Vizitor: Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

Qëllime personale të cilat grupohen në:

1. Pushime. vizitë tek të afërm etj.
2. Trajtime shëndetësore
3. Qëllime fetare
4. Udhëtarë tranzit

Kategoria e biznesit që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm. Për më shumë informacion referojuni:

https://www.instat.gov.al/media/2940/revision_policy_2016.pdf

Diferencat statistikore midis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:

- Ligjit nr.71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, neni 17 “Lehtësimi i verifikimeve Kufitare”, ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuark në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistron shtetasit në hyrje.
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje.
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarojnë shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.